

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ferit Osmani, kryetar i kolegjit, gjyqtarët Hashim Çollaku dhe Biljana Rexhiq, anëtarë, me bashkëpunëtoreshen profesionale Leonita Lajçi, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit N.L., nga Komuna e Skendrajt, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.9 lidhur me par.6 dhe par.1 të KPK, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Gllogoc, P.nr.492/2018, të dt.22.10.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me 14.01.2019, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Gllogoc, P.nr.492/2018, të dt.22.10.2018, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Gllogoc, P.nr.492/2018, të dt.22.10.2018, është shpallur fajtor i akuzuari N.L., për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.9 lidhur me par.6 dhe par.1 të KPK, dhe i është shqiptuar dënimi më burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim më pëlqimin e të akuzuarit zëvendësohet në dënimin më gjobë në shumën prej 4.500 euro, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në rast të mos pagesës, do ta mbaj dënimin e shqiptuar në kohëzgjatje prej 6 muajve. Në dënimin e shqiptuar i llogaritet koha e kaluar në paraburgim në kohëzgjatje prej 22 ditëve dhe atë prej dt.10.08.2016 e gjerë më dt.31.08.2016, si dhe koha e kaluar në arrest shtëpiak në kohëzgjatje prej 31 ditëve dhe atë prej dt.01.09.2016 e gjerë më dt.01.10.2016, që nënkupton gjithsejtë 53 ditë të arrestit shtëpiak dhe të paraburgimit i llogaritet në dënimin e shqiptuar më burg, në rast të mos pagimit të gjobës në afatin e caktuar si më lartë.

Ndaj të akuzuarit shqiptohet dënimi plotësues-ndalimi i drejtimit të automjetit, për kategorinë përkatëse "B" në kohëzgjatje prej 2 viteve, e cila ndalës do të llogaritet nga dita kur aktgjykimi bëhet i plotfuqishëm.

Përfaqësuesi ligjor i tani të ndjerit dhe i të dëmtuarit, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, janë udhëzuar në kontestin e rregullt juridiko-civil.

Është obliguar i akuzuari që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale 60,88euro, paushallin gjyqësor në shumën prej 100 euro, si dhe në emër të programit për kompensimit të viktimave të krimit shumën prej 30 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor ka ushtruar ankesë Prokuroria Themelore në Prishtinë, për shkak të vendimit lidhur më sanksionin penal, duke propozuar që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet vetëm sa i përket vendimit lidhur më sanksionin penal në mënyrë që të akuzuarit ti shqiptohet dënimi më burgim efektiv.

Përgjigje në ankesë të PTH-së në Prishtinë, ka ushtruar mbrojtësja e të akuzuarit av. E.B., duke propozuar që të refuzohet si e pabazuar ankesa e PTH-së në Prishtinë, kurse aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë me shkresën PPA/II.nr.1201/2018, të datës 07.12.2018, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e PTH-së në Prishtinë, ka propozuar që e njëjta të aprovohet si e bazuar dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënimi më burgim efektiv.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 390 të KPPK, ka caktuar seancën e kolegjit për të cilën i ka njoftuar të gjitha palët nga shkresat e lëndës. Nga shkresat e lëndës rezulton se njoftimeve iu janë përgjigjur i akuzuari N.L., mbrojtësi av. H.H., i cili më autorizim zëvendësues e zëvendëson av. E.B., për këtë seancë të kolegjit, kurse munguan Prokurori i Apelit, përfaqësuesi ligjor i tani të ndjerit, përfaqësuesi ligjor i të dëmtuarit.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesa e ushtruar, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

Ankesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, nuk është e bazuar.

Meqenëse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, gjykata duke vepruar në pajtim me nenin 394 të KPPK, e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar nëse i njëjti është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, dhe gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit, të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij, për të cilat kjo gjykatë kujdeset kryesisht sipas detyrës zyrtare.

Sipas ankesës PTH-së në Prishtinë, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar për shkak të vendimit lidhur më sanksionin penal, duke theksuar se në këtë çështje penal gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, mirëpo në rastin e marrjes së vendimit për dënimin, të akuzuarit i ka shqiptuar dënim të ultë, duke patur parasysh se nga ky aksident i komunikacionit ka ndruar jete i ndjeri S. G, kurse lëndime të rënda trupore ka arrur G.G., e gjithashtu gjykata e shkallës së parë nuk e ka marr parasysh se i akuzuari ka qenë duke e drejtuar automjetin më shpejtësi të madhe përkundër asaj që ka qen vendbanim dhe zhvillimi i shpejtësisë është i lejuar deri në 20km/h. Gjithashtu, jemi të mendimit se gjykata e shkallës së parë dhe në prani të këtyre rrethanave gabimisht i ka aplikuar dispozitat e nenit 75 dhe 76 të KPPK, kur dënimin e ka zëvendësuar nga dënimi më burgim në dënimin më gjobë.

Kolegji i kësaj gjykate, e ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë përkitazi më vendimin për dënimin, dhe ka ardhur në përfundim, se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë ka vërtetuar gjendja faktike, se aktgjykimi i ankimuar nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkeljet e ligjit penal, ashtu që kolegji pas vlerësimit të aktgjykimin, vie në përfundim se gjykata e shkallës

së parë, në mënyrë të drejtë ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë me rastin e marrjes se vendimit për dënimin, caktimit të llojit dhe lartësisë së tij, në kuptim të nenit 73 të KPK, sikurse janë rrethanat lehtësuese, se i akuzuari asnjëherë nuk ka qenë i dënuar, se ndaj tij nuk zhvillohet ndonjë procedurë tjetër penale, se është penduar për veprën e kryer penale dhe ka kërkuar falje nga të dëmtuarit, dhe se i kanë normalizuar raportet familjare sipas traditave vëndore, e cila vërtetohet edhe nga deklaratat e përfaqësuesit ligjor, se i akuzuari ju ka qëndruar afër familjeve të ndjerit dhe të dëmtuarit duke i ndihmuar materialisht, se është i martuar, baba i tre fëmijëve, kurse rrethana rënduese ka vlerësuar se nga ky aksident ka humbur jetën një person dhe një tjetër është lënduar rëndë, mirëpo ka aplikuar dispozitat ligjore nga neni 75 dhe 76 të KPPK, përkitazi më zbutjen dhe kufit e zbutjes së dënimeve dhe në kuptim të nenit 47 të KPK, dënimin më burgim e ka zëvendësuar më dënimin më gjobë. Në prani të këtyre rrethanave e duke mos gjetur ndonjë rrethanë posaçërisht rënduese, kolegji i kësaj gjykatë, është i bindur se me dënimin e shqiptuar nga ana e gjykatës shkallës parë, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij i paraparë me nenin 41 të KPK, që të parandaloj kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale, dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1. nr.1197/2018 të datës 14.01.2019

B. profesionale
Leonita Lajçi

Anëtarët e kolegjit
Hashim Çollaku

Kryetari i kolegjit
Ferit Osmani

Biljana Rexhiq